



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, JURIDIKE DHE ARKIVIT

1446
Nr. _____ Prot.

Roskovec, më 14. 02. 2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune për pozicionin “Mësues Ndhmës” në kopshtin e “Lulet e Jetës”, Roskovec , zëvendësuese

**KANDIDATËVE TË PROFILIT ARSIMI PARASHKOLLOR, TË PORTALIT
“MËSUES PËR SHQIPËRINË” 2025**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë; Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës së Bashkisë Roskovec si dhe Njësive Administrative në varësi Kuman, Strum, Kurjan”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 76 datë 23.12.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të bashkisë dhe të Ndermarrjeve Vartëse”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar PBA 2026-2028 dhe buxhetit vitit 2026, miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresë nr.1391/1. datë 06.01.2026 protokolluar në institucionin tone me Nr.10484/3 datë 06.01.2026”, ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar; Udhëzimit Nr. 8, datë 03.05.2024 “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, si dhe në mbështetje të Urdhrit Nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, Kreu XIV, “Arsimimi i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara”, i ndryshuar; shkresës përcjellëse të Zyrës Vendore Arsimore Roskovec Nr. 523/1, datë 17.09.2025 protokolluar në institucionin tonë me Nr.7839/1 datë 18.09.2025, për listën e mësuesve me profil “Arsim Parashkollor” dhe “Arsim Special” me rezultatet e kandidatëve të profilit *Arsimi Parashkollor*, dhe *Arsimi Special* të portalit “Mësues për Shqipërinë” 2025, kërkesës së Drejtorisë së Kulturës dhe Arsimit me Nr.1336, datë 16.02.2025 për fillimin e procedurave për mësues ndihmës.

➤ **Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët për procedurat dhe kriteret e veçanta bazohen në:**

Udhëzimin nr. 26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, Kreu 1, pika 1 dhe pika 5:

1. Mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara (AK) në institucionet arsimore publike duhet të plotësojnë këto kritere:

a) të jetë i pajisur me licencë mësuesi në profilin “Arsim Special”.

b) ku nuk ka mësues të profilit “Arsim Special” duhet të jetë i pajisur me diplomë të ciklit të dytë në fushën e “Edukimit”, konform kërkesave të Nenit 57, pika 2 e Ligjit 69/2012, i ndryshuar si dhe të ketë kryer trajnime për arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuar dhe të jetë i pajisur me certifikatë/ dëshmi /diplomë që vërteton këtë kompetencë profesionale të shtuar.

2. Në një klasë ku ka më shumë se 1(një) nxënës me AK nuk mund të punonjë më shumë se një mësues ndihmës.

Duke qënë se në institucionin tonë rezulton **1 (një) vend i lirë pune si zëvendësuese në pozicionin:**

- **“Mësues Ndhmës” në kopshtin e “Lulet e Jetës”, Roskovec**

bazuar në listën me rezultatet e kandidatëve të “Portalit Mësues për Shqipërinë 2025”, do të vijojë procedurën Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit sipas udhëzimit përkatës për këto pozicione pune dhe renditjes së portalit “Mësues për Shqipërinë”, sipas listës bashkëngjitur.

Kandidati që do të pranojë këtë pozicion pune duhet të konfirmojë nëpërmjet e-mailit brenda 24 orëve, nëse pranon vendin e punës, si dhe të paraqitet menjëherë sapo ka marr njoftimin, pranë bashkisë Roskovec, me dokumentat si më poshtë:

1. Kërkesë për aplikim,
2. Curriculum Vitae,
3. Fotokopje e Kartës së Identitetit;
4. Çertifikatë e përbërjes familjare;
5. Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë dhe listës së notave ;
6. Certifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);

KRYETARI

Majlinda Bufi

